



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:121741

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05363547

KE.nr. 2642/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit “Company Bejta Commerce” Sh.A., me numër të biznesit 70038754 dhe seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.G., kundër të paditurës Komuna e Shtimes, me objekt kontesti kompensimi i dëmit, vlera e objektit të kontestit EUR 100,440.79, pas mbajtjes shqyrtimit kryesor publik me datë 15.02.2024, në të cilin kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, me datë 23.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Company Bejta Commerce” Sh.A., me seli në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Shtimes, që paditësit t’ia paguaj shumën e mjeteve financiare në lartësi prej EUR 100,440.79 me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 21.05.2008 e deri në përmbushjen definitive.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Company Bejta Commerce” Sh.A., me seli në Gjilan, me datë 23.08.2018, ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, ndaj të paditurës Komuna e Shtimes, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj mjetet financiare në shumë prej EUR 100,440.79, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 21.05.2008 e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës.

Paditësi në padi ka theksuar se ka lidhur kontratën e punës nr. 08/07, të datës 09.08.2007, për kryerjen e punimeve në parkun teknologjik “Teknopolis” në Shtime, me operatorin ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., me seli në Davidoc, Komuna e Shtimes. Ka theksuar se paditësi i është përmbajtur kontratës ashtu që, pas përfundimit të punëve të kryera dhe të pranuar nga organi mbikëqyrës, ka dorëzuar faturat për pagesë, mirëpo që operatori ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., nuk ka përmbushur detyrimin ndaj paditësit. Në këtë drejtim, paditësi ka paraqitur propozim për përbarim ndaj këtij operatori, ndërsa Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin E.nr. 138/09, të datës 27.05.2009 ka urdhëruar bllokimin e llogarive në emër të “Parkut Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., me seli në Shtime, mirëpo që nuk është arritur të realizohet borxhi për shkak se ky operator ekonomik ka falimentuar. Andaj si rezultat i kësaj, paditësi i është drejtuar Komunës së Shtimes, këtu të paditurës për mundësinë e gjetjes së marrëveshjes për kompensimin e borxhit në emër të punëve të kryera nga ana e paditësit, pasi që e paditura Komuna e Shtimes ka marrë në posedim parkun ekonomik dhe është pronare e paluajtshmërisë ku është dashur të ndërtohet parku teknologjik, mirëpo që e paditura ka refuzuar që të kompensojë paditësin në emër të punëve të kryera. Nisur nga këto, gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që të detyrohet e paditura Komuna e Shtimes që paditësit t’ia paguajë mjetet financiare në shumë prej EUR 100,440.79, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 21.05.2008 e deri në përmbushjen e plotë të detyrimit, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Shtimes, përmes përgjigjes në paditë të dorëzuar në gjykatë me datë 15.10.2018 ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa ka shtuar se e paditura nuk ka lidhur asnjë kontratë pune me paditësin, mirëpo që paditësi ka lidhur kontratë pune me kompaninë “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., të cilës i është dhënë leja ndërtimore për ndërtimin e Parkut Teknologjik në Komunën e Shtimes, andaj gjykatës i ka propozuar që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin C.nr. 776/18, të datës 23.08.2020, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit të paraqitur ndaj të paditurës me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguajë shumën e mjeteve financiare në vlerë prej EUR 100,440.79, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 21.05.2008 e deri në përmbushjen definitive.

Ndaj këtij aktgjykimi, paditësi ka paraqitur ankesë pranë gjykatës së shkallës së dytë. Ndërsa, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktgjykimin Kom.Dh.Shk.II.nr. 77/22, të

datës 28.10.2022, ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 776/18, të datës 23.07.2020, e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Në seancat e mbajtura si dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka qëndruar në tërësi pranë kërkesëpadisë duke shtuar se paditësi ka kryer punime në vlerë prej EUR 100,440.79 në Parkun Teknologjik “Teknopolis” në Komunën e Shtimes, të cilat punime janë kryer sipas kontratës së lidhur me operatorin ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., të cilit i është dhëna leja ndërtimore nga ana e të paditurës, mirëpo që ky operator tanimë ka falimentuar. Ndërsa, ka shtuar se pas përfundimit të punimeve, paditësi i është drejtuar Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes me kërkesë që e njëjta ta kompensoj paditësit për shkak se prona ku është dashur të ndërtohet parku teknologjik është kthyer në posedim të të paditurës e cila disa bizneseve të tjera ua ka dhënë në shfrytëzim. Andaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Ndërsa, përfaqësuesi i të paditurës në seancat e mbajtura si dhe fjalën përfundimtare, ka theksuar se Komuna e Shtimes vetëm ka dhënë pronën në shfrytëzim për ndërtimin e parkut teknologjik dhe nuk është garantuese e shoqërisë “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K. Në fund, ka theksuar se Komuna e Shtimes nuk ka asnjë obligim financiar ndaj paditësit, ndërsa gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata me propozimin e palëve ka zhvilluar procedurën dhe në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes ka administruar provat si në vijim: Kontratën mbi punën nr. 08/07, e datës 09.08.2007 e lidhur mes paditësit dhe operatorit “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K.; Propozimin për përmbarim të ushtruar nga paditësi me datë 15.05.2009, ndaj debitorit “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K.; Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut E.nr. 138/09, të datës 23.05.2012; Kërkesën e paditësit nr. 02/070/05, të datës 12.07.2018, drejtuar Komunës së Shtimes; Përgjigjen e të paditurës nr. 02/390, e datës 13.07.2018 në kërkesën e paditësit; Situatën e përkohshme e datës 21.05.2008 lidhur me vlerën e kontratës për pagesën e punimeve të kryera; Librin ndërtimor për parkun teknologjik në Komunën e Shtimes; Vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e Parkut Teknologjik “Teknopolis” me nr. 01/06/7425/5/1, të datës 29.05.2007; Vendimi nr. 01/170, i datës 27.05.2009, për anulimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Agjencionit për Zhvillim Ekonomik “EDA”; Leja për ndërtimin

e lëshuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes, me nr. 06/351/7847, të datës 25.07.2007; Aktvendimin nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në kuadër të UNMIK-ut, me nr. 00211-58, i datës 30.07.2007, si dhe; Certifikatën e regjistrimit të biznesit në emër të Agjencionit për Zhvillim Ekonomik “EDA”.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: “LPK”), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, duke vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga provat e administruara dhe nga vet deklaratimet e palëve, nuk ishte kontestuese se e paditura Komuna e Shtimes ia kishte dhënë në shfrytëzim Agjencionit për Zhvillim Ekonomik “EDA”, pronën komunale për ndërtimin e Parkut Teknologjik “Teknopolis” në Shtime, fakt ky i vërtetuar edhe nga Vendimi nr. 01/06/7425/5/1, i datës 29.05.2007. Ndërsa, sipas Aktvendimit nr. 00211-58, i lëshuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes, rezulton se është aprovuar kërkesa për regjistrimin e së drejtës në shfrytëzim të paluajtshmërisë në regjistrin e paluajtshmërive në emër të Agjencionit për Zhvillim Ekonomik “EDA”, me seli në Shtime.

Mes palëve nuk ishte kontestues se paditësi “Company Bejta Commerce” Sh.A., ka lidhur kontratë mbi punën me operatorin ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., me seli në Shtime, për ndërtimin e fazë së partë të ndërtimit të ulët, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga kontrata mbi punën nr. 08/07, e datës 09.08.2007.

Poashtu, nuk ishte kontestuese se paditësi kishte kryer punë ndërtimore në Parkun Teknologjik “Teknopolis”, për llogari të investitorit – operatorit ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., fakt ky që gjen mbështetje edhe në situatën e përkohshme e punëve të kryera e datës 21.05.2008 e nënshkruar nga paditësi si punë kryes dhe investitori “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., si dhe libri ndërtimor për Parkun Teknologjik në Shtime.

Nuk ishte kontestues as fakti se e paditura Komuna e Shtimes kishte anuluar vendimin për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale Agjencionit për Zhvillim Ekonomik “EDA”, fakt ky i vërtetuar nga Vendimi nr. 01/170, i datës 27.05.2009.

Ndërsa, nga propozimi për përmbarrim i datës 15.05.2009, dhe Aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, E.nr. 138/09, i datës 15.05.2009, gjykata gjen se këtu paditësi ka iniciuar procedurë përmbarrimore ndaj subjektit ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis”

Sh.P.K., për realizimin e borxhit në emër të punimeve të kryera në Parkun Teknologjik në vlerë prej EUR 100,440.79.

Nga kërkesa me numër 02-07/05, e datës 12.07.2018, rezulton se paditësi i është drejtuar këtu të paditurës Komunës së Shtimes me kërkesë për gjetjen e mundësisë për pagesë të punëve të kryera në Parkun Teknologjik “Teknopolis” në shtime në vlerë prej EUR 100,440.79, ndërsa nga shkresa me numër 02/390, e datës 13.07.2018, rezulton se e paditura i është përgjigjur kërkesës së paditësit duke theksuar se e paditura nuk ka asnjë raport kontraktual me paditësit dhe rrjedhimisht nuk ka obligime ndaj paditësit.

Megjithatë, kontestuese mes palëve ishte fakti nëse e paditura mban përgjegjësi për kthimin e borxhit paditësit për punët të cilat paditësi i ka kryer sipas kontratës së punës të lidhur me operatorin ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K.

Në këtë drejtim, pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe pas administrimit me prova në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar. Deri tek ky vlerësim të tillë, gjykata erdhi duke u bazuar në kontratën mbi punën nr. 08/07, e datës 09.08.2007, përmes së cilës vërtetohet fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie kontraktuale në cilësi të punëkryesit me operatorin ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., dhe jo Komunën e Shtimes, këtu e paditur. Në këtë drejtim, gjykata gjen se paditësi me të paditurën nuk ka asnjë raport kontraktual, mbi bazën e së cilit raport do të linde e drejta subjektive e paditësit për të kërkuar mbrojtje ligjore, përkatësisht për të kërkuar pagesën e mjeteve financiare prej ERU 100,440.79, në emër të punëve ndërtimore të kryera në Parkun Teknologjik “Teknopolis” në Shtime.

Andaj, gjykata vlerëson se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë, përkatësisht i mungon përgjegjësia për kompensimin e borxheve apo detyrimeve eventuale të krijuara nga kontrata mbi punën e lidhur mes paditësit dhe personit të tretë operatorit ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., pasi që e paditura nuk është pjesëmarrëse në asnjë raport juridik me paditësin.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e paditësit se i njëjti nuk ka mundur që ta realizoj të drejtën e tij ndaj operatorit ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., ngase ky i fundit ka falimentuar, dhe rrjedhimisht i është drejtuar Komunës së Shtimes për kompensim për faktin se kjo e fundit ka kthyer në posedim pronën ku ka pasur të ndërtohet parku teknologjik, mirëpo pavarësisht faktit nëse paditësi ka dështuar apo jo të realizoj të drejtën e tij nga operatori

ekonomik me të cilën ka pasur raport kontraktual, gjykata gjen se detyrimet e krijuara mes paditësit dhe personit të tretë nuk mund të barten në të paditurën përderisa paditësi dhe e paditura nuk kanë asnjë raport kontraktual mes tyre.

Në këtë drejtim gjykata gjen se paditësi, përkundër që në kuptim të nenit 319.1 të LPK-së, ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e tij, i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të bënte të besueshme se ekziston përgjegjësia e të paditurës për detyrimin për kthimin e borxhit prej EUR 100,440.79. Ndërsa, nga provat të cilat janë propozuar dhe administruar përgjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje kontestimore nuk është vërtetuar se ekziston ndonjë raport juridik detyrimor ndërmjet paditësit dhe këtu të paditurës Komuna e Shtimes, mirëpo vetëm raporti i paditësit i krijuar me një person të tretë, përkatësisht operatorin ekonomik “Parku Teknologjik Teknopolis” Sh.P.K., raport ky i cili nuk e obligon këtu të paditurën Komuna e Shtimes.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vlerëson se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë çështje juridike nga fakti se e paditura nuk është pjesëmarrëse në raportin juridik detyrimor me paditësin, respektivisht nuk është subjekt në raportin juridik, nga i cili paditësit i derivon e drejta subjektive, për të kërkuar mbrojtje ligjore.

Nga sa më sipër, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 2642/22, datë 23.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.